



01/Nr **2176** 2023
Data : 13.03.2023

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dytë -II- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa , mbajtur me datë 16.02.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjan** (Nënkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Ajete Berisha** (Udhëeqëse e Personelit), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Xhevedet Bushi** (Shef i Zyrës së Prokurimit), **Vjollca Livoreka** (Zyrtare për Barazi Gjinore), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesi i OSB-së.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.
4. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2020 , 2021 dhe 2022 në vitin 2023.
5. Raporti financiar për vitin 2022 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjan thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- kur do të fillojnë punimet për projektin te Ura e Seçishtës.

Refet Kalisi thekson:- kur do të bëhet implementimi i trotuarit te Ura e Seçishtës prej zyrës Japoneze që e keni donacion.

Nexhmedin Daci thekson:- marrëveshjen e kemi arritur me kompaninë “Sharcem” dhe kemi arritur me bërë projektin dhe besoj që në muajin maj do të fillojnë punimet. Ambasada Japoneze në muajin dhjetorë i ka lëshuar mjetet dhe janë iniciuar procedurat e prokurimit.

Ibadete Kalisi thekson:- a keni bërë ndonjë marrëveshje për ndriçimin publik.

Arsim Dernjani thekson:- janë zhvilluar procedurat për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- jam i kënaqur me punën e kuvendit që është bërë , falënderoj juve si kryesues për hapësirën që na i ke dhënë.

Sherif Berisha thekson:- i bashkëngjitem fjalëve të parafolësit edhe unë nuk kam vërejtje në këtë drejtim.

Nora Xhoni thekson:- ju falënderoj për kryesimin mbledhjeve që i ke bërë sepse na ke dhënë hapësirë për me u shprehur lirshëm në asamble.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2020 , 2021 dhe 2022 në vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- mjetet financiare të cilat do të barten i kemi shënuar në detale në materialin të cilin e kemi përcjell dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- sa është shuma e të hyrave të cilat nuk janë inkasuar për vitin 2022. Rruga “Isa Berisha” ndriçimi asfaltim ne e dimë që Parkun e kemi ndriçuar, kërkoj sqarim se për investimet që po i planifikoni me i bërë.

Lindita Ballazhi thekson:- 88 % janë inkasuar nga planifikimi i të hyrave dhe nëse kalkulohe me të hyrat indirekte kemi një tejkalim të të hyrave së bashku e donacionet. Më saktë do të ju informoi në kuvend.

Nexhmedin Daci thekson:- kompania nuk i ka kryer të gjitha punimet dhe nuk e kemi kryer pagesën edhe pse i kemi pasur mjetet financiare por këtë mjete financiare do të barten në këtë vit dhe në momentin që do të kryhen punimet pagesa i bëhet.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Raporti financiar për vitin 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Bajrami thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Refet Kalisi thekson:- sa ekonomi familjare i kemi të pa regjistruara të cilat nuk paguajnë për mbeturina. Shpenzimet e reprezentacionit ishin të rritura .

Sevime Bajrami thekson:- jemi tu bërë përpjekje për këtë çështje por është problem me arritur me bërë një data bazë edhe pse është duke u munduar kompania. Tash duhet me kuptuar se çmimet janë ngritur për atë është bërë rritja e reprezentacionit.

Sherfi Berisha thekson:- duhet të njoftohem kur mbanë takim bordi sepse jemi komision i aksionarëve.

Sevime Bajrami thekson:- nuk jemi të detyruar me qenë në çdo muaj kur mbajnë ata mbledhje.

Kryesuesi thekson:- besoj që puna e ashensorit do të rregullohet. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINACIARË PËR VITIN 2022 I NPL PASTRIMI SH.A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- të gjitha të dhënat i kemi shënuar në material në mënyrë të detajuar dhe nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATATA MBI PROCESIN E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE DHE LEGALIZIMIN E TYRE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme

Kryesuesi thekson:- ju njoftoj për çështjen e bordit të kompanisë “Sharrcem” se vërehet që nuk është diçka në rregull por atë bord nuk e kemi zbuluar na por ka qenë i trashëguar që më herët që ka të bëjë me komunitetin. Ne kemi pasur vetëm një takim më herët për të cilin e dini edhe ju që kemi biseduar edhe çështja e pagesës së psikologes për shkollat e Hanit të Elezit dhe është kryer. Kërkesat që kanë të bëjnë me kompaninë “Sharrcem” duhet të shkojnë përmes këtij bordit dhe anëtarët e bordit e paraqesin kërkesën në kompaninë “Sharrcem” dhe kjo varet prej mundësive se a mund të kryhet apo jo. Ne kemi kërkuar takim por shihet që është një anashkalim për shkak se prej muajit dhjetorë nuk kemi pasur takim. Kërkesat janë transparente dhe kemi me kërkuar që me u rrit shuma e mjeteve financiare për shkak se ka kërkesa të ndryshme prej komunitetit dhe sporteve. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherfi Berisha thekson:- si qytetarë po e thithim pluhurin dhe si pasoj po shkaktohen sëmundje të ndryshme prej kancerit . Është mirë që të merren më seriozisht për këtë çështje për shkak se mund të organizojmë edhe protesta . Duhet të ju shkruani përsëri për çështje të takimit dhe të na njoftoni për këtë çështje.

Refet Kalisi thekson:- kompanisë “Preni” ju ka ndërprerë kontrata dhe është mirë me biseduar për shkak se edhe ata janë taksa pagues të komunës sonë dhe janë pesëdhjetë punëtorë që duhet të largohen nga puna ju si bord është mirë që ta bisedoni që mos me ja ndërprerë kompania “Sharrcem” kontratën.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:53 .

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Komitetit

Florim Shkreta

